



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.81 dt.05.06.1998

**Këshilli i Bashkisë së Tiranës, në mbledhjen e tij dt.05.06.1998, pasi shqyrtoi materialin e Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike dhe Shërbimeve në Bashki “Relacion mbi përcaktimin e pagës bazë të Anëtarëve të Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes së Ujësjetës të Tiranës”, mbështetur në ligjin Nr.7852, dt.13.07.1992 për Ndërmarrjet Shtetërore si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.214 dt.28.03.1998 “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.345, dt.10.08.1992 “Mbi shpërblimin e pagave të punonjësve”.**

**V E N D O S I**

- 1. Paga mujore bazë, e Drejtorit të Ndërmarrjes së Ujësjetës të Tiranës të jetë : 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.**
- 2. Në vartësi të pagës së Drejtorit, përcaktohen pagat e Anëtarëve të tjerë të Këshillit Drejtues të kësaj Ndërmarrje.**
- 3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve.**
- 4. Ky Vendim hyn në fuqi që me dt.01.04.1998.**

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**